



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:067166

Datë: 10.09.2019

Numri i dokumentit: 00522681

P.nr.799/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit E.M., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve në bashkëkryerje në nga neni 314 par.5 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.nr.1639/18, të datës 12.11.2018, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar, publik, **me datë 10.09.2019**, në prezencën e Prokurores së shtetit Mone Syla si dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli dhe e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

E.M., nga i ati S., e ëma V., e gjinisë H., data e lindjes..., Komuna e Gjakovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, punon si automekanik, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, numër personal....

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën 14.10.2018, rreth orës 00:30 minuta, në Gjakovë, në rrugën “G.K.”, me qëllim përvetësimi të kundërligjshëm për veten apo tjetrin, i marrin pasurinë e luajtshme të dëmtuarit – P. së D. “N.B.” në Gjakovë, në atë mënyrë që shkojnë me automjetin e tipit “Audi 80”, ngjyrë e kuqe, me targa të regjistrimit ..., ndalet në pompën e derivateve dhe punëtorit të pompës A.B. nga Gjakova, i kërkojnë që ti furnizojë automjetin me naftë në vlerë prej 40 Euro, me ç’rast pasi e furnizojnë automjetin, largohet me të shpejtë pa paguar fare.

Me këto veprime ka kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve në bashkëkryerje në nga neni 314 par.5 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par. 1, 38, 39, 40, 43, 69, 70, dhe nenit 314 par.5 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej 160 (njëqindegjashtëdhjetë) Euro të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë, atëherë i zëvendësohet dënimi me gjobë me dënim me burgim, në kohëzgjatje prej 8 (tetë) ditëve, duke iu llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 (njëzet) Euro.

E dëmtuara P.D.“N.B.” në Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest juridiko-civil.

Detyrohet i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 30 (tridhjetë) Euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 (tridhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate, ka ngritur aktakuzën me numër PP.nr.1639/18, të datës 12.11.2018, kundër të akuzuarve: P.M. dhe E.M., që të dy nga Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale Vjedhje në bashkëkryerje nga neni 325 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 10.09.2019, ku prezent ka qenë Prokurorja e shtetit Mone Syla dhe i akuzuari E.M., ndërsa për të akuzuari P.M., gjykata kishte lëshuar urdhëresë për sjellje me forcë mirëpo nga Stacioni Policor në Gjakovë me anë të raportit me numër Ref.nr..., të datës 09.09.2019, gjykata është njoftuar si lidhur me këtë person, të njëjtin e kemi kërkuar në shtëpinë e tij por nuk e kemi gjetur, nga nëna e tij jemi njoftuar se P.M. që një kohë gjendet në Belgjikë.

Gjykata duke vendosur sipas propozimit të prokurores së shtetit Mone Syla që të veçohet procedura ndaj të akuzuarit P.M., ka marrë Aktvendim me të cilin ka aprovuar kërkesën e prokurores së shtetit ashtu që është veçuar procedura penal kundër të akuzuarit P.M., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale të vjedhjes në bashkëkryerje nga neni 325 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ashtu që procedura ndaj tij do të zhvillohet ndaras dhe do të merr numrin e ri sipas regjistrimit penal të Departamentit të Përgjithshëm të kësaj gjykate.

Prokurorja e Shtetit Mone Syla, gjatë shqyrtimit fillestar, pas leximit të aktakuzës ka deklaruar se bën rikualifikimin e veprës penale për të akuzuarin P.M. dhe E.M. që të dy nga Komuna e Gjakovës, ashtu që nga vepra penale e vjedhjes në bashkëkryerje nga neni 325 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në veprën penale të vjedhjes së shërbimeve në bashkëkryerje nga neni 326 par.1 të KPRK-së, andaj duke marr për bazë që me hyrje në fuqi të Kodit të Ri Penal i cili ka hy në fuqi me datën 14.04.2019, vepra penale vjedhje e shërbimeve është përcaktuar nga neni 314 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së e që është më i favorshëm për të

akuzuarit për shkak se sipas nenit 326 par.1 të KPRK-së (Kodi i Vjetër) për këtë veprë penale parasheh dy dënime atë me gjobë dhe burgim deri në 1 vit ndërsa sipas nenit 314 par.1 parashihet dënimi me gjobë ose me burgim deri në (3) tri vite, e që konsideroj se është më i favorshëm për të akuzuarin për shkak se për këtë veprë parashihet vetëm një dënim dhe jo dy dënime kryesore andaj edhe bëj rikualifikimin e veprës penale nga neni 326 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së (Kodi i Vjetër) në veprë penale të vjedhjes së shërbimeve në bashkëkryerje nga 314 par.5 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së (Kodi i Ri). Prokurorja e Shtetit Mone Syla, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës ndaj të akuzuarit të lartpërmendur dhe ka propozuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari E.M. gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se : e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe ka shtuar se është e vërtetë që e kemi mbushur veturën me 40 Euro naftë dhe vetura ka qenë e imja, por ka qenë duke e vozitur P., prandaj jam penduar për këtë veprim dhe i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsërisë veprime të këtilla dhe do të jetë më i kujdesshëm.

Prokurorja e shtetit Mone Syla, duke dhënë mendim rreth pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e bën me vetëdije dhe vullnet të plotë, pa presion, i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe po ashtu që pranimi fajësisë mbështetet edhe në provat dhe në faktet që janë bashkangjitur akuzës.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmbajnë aktakuzat, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuzat nuk përmbajnë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzave.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këto gjendje faktike:

- Se i akuzuari E.M. ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve në bashkëkryerje nga neni 314 par.5 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin të këtij Aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 314 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale vjedhja e shërbimeve e kryen: “*Kushdo që me anë të lajthimit, largimit ose mënyrave tjera siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet*”.

Ndërsa në paragrafi 5 të këtij neni është përcaktuar se “Largimi nga biznesi, hoteli apo restoranti pa ofruar për të paguar ose pa paguar për hotel, restorant apo shërbime tjera për të cilat kompensimi zakonisht paguhet pas pranimit të shërbimeve është dëshmi se shërbimet janë pranuar me qëllim të shmangies së pagesës”. Ndërsa, në nenin 31 është parashikuar bashkëkryerja si lloj i bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale: e cila konsiderohet se ekziston “Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale.

5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Andaj, duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, gjyqtari i vetëm gjykues ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit E.M. formohen të gjitha elementet e veprës penale të vjedhjes së shërbimeve në bashkëkryerje nga neni 314 par.5 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimeve

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit ku si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar se, është mbajtës i familjes prej 4 (katër) anëtarësh, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, faktin se me më parë nuk ka qenë i dënuar. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestarë për veprën penale për të cilën ngarkohet, pendimin e tij dhe shprehjen e keqardhjes për rastin e ndodhur. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike

Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par.2 të KPP-së.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.799/18, me datë 10.09.2019

Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Mentor Bajraktari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.